

Aplikim për uljen e tarifës vjetore të shkollimit, për studentët e Ciklit të dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2024-2025

Master i Shkencave, Master Profesional

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, VBA-së nr. 51 datë 28.10.2024 “Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve “Për ulje tarife vjetore shkollimi në vitin akademik 2024-2025, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi të Ciklit të dytë të studimeve - Master”.

NJOFTON:

I- Të gjithë studentët e regjistruar në programet e **Ciklit të dytë të studimit – Master i Shkencave e Master profesional, program i parë studimi**, që plotësojnë kriteret për “**Ulje nga tarifa vjetore e shkollimit e vitit akademik 2024-2025**” dhe vijnë nga shtresa sociale:

1. Student me aftësi të kufizuara.
2. Studentë fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore i ndryshuar.
3. Studentët familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore.
4. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve.
5. Studentët që kanë përfutur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.
6. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë.
7. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfutur statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore.
8. Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
9. Studentët romë dhe Ballkano-egjiptianë.
10. Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

II- Studentët e Ciklit të dytë të studimeve – Master i Shkencave e Master profesional, program i parë studimi, të interesuar për ulje të tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2024 – 2025, të plotësojnë kërkesën duke **filluar nga data 01.11.2024**, duke plotësuar kërkesën sipas formatit të përcaktuar, si dhe do të bashkëlidhin dokumenta për kriteret që kërkojnë, sipas formatit “**DEKLARIM (KËRKESË) PËR ULJE NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**” e cila të shkarkohet nga: www/uniel.edu.al, Rubrika/ Zona e studentit/ njoftime dhe ta dërgojnë në adresën: **Zyra e Këshillimit Karrierës dhe ALUMNI/ Korpusi kryesor/ Kati i dytë**

(Plotëso të dhënat e domosdoshme në pozicionin e vijëzuar për kriterin që i përkisni dhe dorëzoje dokumentin e plotësuar, së bashku me dokumentet e kërkuara bashkëlidhur, në adresën e cituar më sipër)

III- Për çdo sqarim të nevojshëm për të përfutur ulje nga tarifa vjetore e shkollimit studentët do të kenë specialistë : **Zyra e Këshillimit karrierës dhe ALUMNI/ Korpusi kryesor/ Kati i dytë**

V.O. Afati përfundimtar i dorëzimit të kërkesave online për studentët e Ciklit të dytë të studimeve – Master i Shkencave e Master Profesional për ulje tarife shkollimi është deri me datë 24.12.2024

Nuk përfitojnë ulje nga tarifa vjetore e shkollimit

1. Studentët që vazhdojnë studimet në program të dytë studimi (studentët që studiojnë për diplomë të dytë – master ose kanë mbaruar një shkollë të lartë – master ose ekuivalent me master)
2. Studentët që nuk janë brenda kohëzgjatjes normale të studimit sipas përcaktimeve në aktet normative
3. Studentët që janë në gjendje civile **të ndarë nga trangu familjar** (figuron i vetëm)

Formulari (kërkesa) i deklaramit gjendet në adresën www.uniel.edu.al /Zona e studentit/ njoftime

REKTORATI

Formulari (kërkesa) i deklarimit për “Ulje nga tarifa vjetore e shkollimit e vitit akademik 2024-2025”

Ciklit të dytë të studimit – Master i Shkencave e Master profesional,
Të shkarkohet në adresën www.uniel.edu.al /Zona e studentit/ njoftime

